



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 129 Akti

Nr. 176 Vendimi
Tiranë, më 8.7.2019

V E N D I M

Trupit gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Pamela Qirko	Kryesuese
Genta Tafa (Bungo)	Anëtare
Etleda Çiftja	Relatore

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Olsida Goxhaj, në prezencë edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Marie Tuma, në datën 4 korrik 2019, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, kati i I-rë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Zeqir Hoda, prokuror pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë.**

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;**
Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;
Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Etleda Çiftja, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, z. Zeqir Hoda, vëzhguesen ndërkombëtar, znj. Marie Tuma, dhe pasi shqyrtoi në tërësinë e saj çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit, i cili në seancë dëgjimore publike kërkoi konfirmimin e tij në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT PROCEDURALE

1. Z. Zeqir Hoda është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit të tij si prokuror pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, bazuar në nenin 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar” dhe në ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016).

2. Në bazë të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, z. Zeqir Hoda, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, duke u shortuar në datën 15.3.2018 me trupin gjykues të përbërë nga:

Pamela Qirko	Komisionere
Genta Tafa (Bungo)	Komisionere
Etleda Çiftja	Komisionere

3. Menjëherë pas hedhjes së shortit, u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”) sipas neneve 31 - 33 të ligjit nr. 84/2016; nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim si “DSIK”) sipas neneve 34 - 39 të ligjit nr. 84/2016; dhe nga Prokuroria e Përgjithshme (në vijim si “PP”) sipas neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016.

4. Trupi gjykues i shortuar në Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim si “Komisioni”), me vendimin nr. 1, datë 26.3.2018, pas studimit të raporteve të sipërpërmendura të vlerësimit, të hartuara nga institucionet shtetërore, vendosi të fillojë hetimin administrativ të thellë dhe të gjithanshëm sipas nenit 45, të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit; të caktojë kryesuese të trupit gjykues komisioneren Pamela Qirko. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.

5. Në datën 12.6.2019, trupi gjykues, me vendimin nr. 2 vendosi: (i) të përfundojë hetimin paraprak për subjektin e rivlerësimit, z. Zeqir Hoda, bazuar në relatimin mbi rezultatet e hetimit të paraqitur nga relatori i çështjes; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit se i ka kaluar barra e provës mbi rezultatet e hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, in interpretuar në lidhje me nenet D, DH dhe E, të Aneksit të Kushtetutës; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47, të ligjit nr. 84/2016, dhe me nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji në lidhje me deklarin e konfliktit të interesit, me të drejtën për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, si edhe me afatin brenda të cilit mund t’i ushtrojë këto të drejta.

6. Në datën 13.6.2019, përmes postës elektronike, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës sipas nenit 52, të ligjit nr. 84/2016 dhe të sjellë prova për të provuar të kundërtën, nëse disponon, brenda datës 26.6.2019; (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47, të ligjit nr. 84/2016, dhe me nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative, duke paraqitur kërkesë për njohje me dosjen brenda pesë ditëve nga marrja e njoftimit me *e-mail*; (iv) si dhe përbërjen e trupit gjykues.

7. Subjekti i rivlerësimit në datën 20.6.2019 paraqiti në Komision kërkesën për marrjen në pyetje të shtetasës A.D., në cilësinë e dëshmitares.

8. Me vendimin nr. 3, datë 2.7.2019, trupi gjykues vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, z. Zeqir Hoda, në seancë dëgjimore në përputhje me nenin 55, të ligjit nr. 84/2016. Përmes postës elektronike subjekti i rivlerësimit u njoftua se seanca dëgjimore do të zhvillohej në datën 4.7.2019, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, kati i I-rë, Tiranë.

9. Trupi gjykues, bazuar në pikën 1, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Zeqir Hoda, bazuar në të tria kriteret e rivlerësimit: të vlerësimit të pasurisë; të kontrollit të figurës; dhe të vlerësimit të aftësive profesionale.

II. SEANCA DËGJIMORE

10. Në datën 4.7.2019, u zhvillua seanca dëgjimore, në prezencë të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016 edhe në prani të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Marie Tuma. Në seancë subjekti i rivlerësimit u paraqit vetë personalisht.

11. Seanca dëgjimore e datës 4.7.2019 u ndërpre, për të rifilluar, në datën 8.7.2019, për shpalljen e vendimit. Në përfundim të seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

12. Subjekti i rivlerësimit, z. Zeqir Hoda, ka qenë bashkëpunues gjatë gjithë procesit në përputhje me nenin 48, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

13. Procesi i rivlerësimit që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Sipas kreut IV, V dhe VI të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”:

- i. ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të paraqitur një raport me konstatime në lidhje me vlerësimin pasuror;
- ii. DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë kontrollin e figurës së subjekti të rivlerësimit duke paraqitur në Komision një raport me konstatimin në lidhje me përshtatshmërinë apo papërshtatshmërinë e subjekti të rivlerësimit; dhe
- iii. Prokuroria e Përgjithshme është organi përkatës i vlerësimit profesional i cili në përfundim të shqyrtimit të dokumenteve ligjorë të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe pesë dokumenteve të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, përgatit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar.

14. Referuar vendimit nr. 2/2017¹ të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, Komisioni realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe

¹ Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit nr. 84/2016: “Komisioni

rivlerësimi i cili nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

V. RIVLERËSIMI I PASURISË

V/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

15. ILDKPKI-ja, me shkresën nr. ***, datë 22.1.2018, në përputhje me nenin 33, të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Zeqir Hoda, i cili është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2003, me numër indeksi *** dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar.

16. Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar deklaratat e interesave private nga viti 2003 deri në vitin 2016 dhe, referuar ligjit nr. 84/2016, ka dorëzuar në datën 25.1.2017 “Deklaratën e Pasurisë së Rivlerësimit Kalimtar, Vetting”. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personave të lidhur, është konstatuar:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

V/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

17. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni hetoi dhe vlerësoi të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti në ILDKPKI në “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting” të vitit 2017; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratat vjetore të deklarimit të pasurisë në ILDKPKI nga viti 2003 deri në 2016; (d) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (e) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik; (ç) shpjegimet me shkrim dhe provat e dërguara nga ana e subjektit të rivlerësimit në datën 27.6.2019, e në vijim, deri ditën e seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

18. Komisioni hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, hetim i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; (ii) në verifikimin e burimeve të krijuarit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të

dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryhen vetë Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit nr. 84/2016, parashikohet se “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se: “Në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) në evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose përdorim; dhe (iv) në evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuar nga pika 5, e nenit 33, e ligjit nr. 84/2016.

V/3 Në lidhje me pasuritë dhe likuiditetet e deklaruara në “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting” të vitit 2017, nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur

1. Apartament banimi, me sip. 92 m², ndodhur në “**”, Tiranë.**

a. Komisioni, për vërtetimin e faktit, administroi:

1.1 Deklaratën “Vetting” të viti 2017 dhe dokumentacionin bashkëlidhur².

1.2 Dokumentacionin e administruar nga ILDKPKI-ja dhe nga Komisioni.

1.3 Provat shkresore dhe deklaratat e administruara nga Komisioni.

b. Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me ligjin e zbatueshëm

1.4 Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka në bashkëpronësi të familjes dhe të vajzës një apartament banimi, me sip. ndërtimi 106.7 m² dhe me sip. shfrytëzimi 92.75 m², në adresën “****”, pll. ***, shk. ***, ap. *** (pallati i Entit të Banesave), Tiranë, në vlerë 3.900.000 lekë, kontrata nr. ***, datë 2.11.2001, ku palët deklarojnë se pagesa nga blerësi tek shitësi është bërë e plotë dhe e menjëhershme jashtë zyrës noteriale. Kjo pasuri në certifikatën e pronësisë së lëshuar në datën 19.2.2015 dokumentohet: apartament me sip. 92.70 m², numri i pasurisë ***, vol. ***, f. ***, me adresë: Rruga “****”, godina ***, h. ***, ap. ***, Tiranë.

1.5 Si burim krijimi subjekti ka deklaruar: (i) kursime familjare në shumën 1.600.000 lekë, të mbledhura nga paga e tij (gjatë viteve të punës nga muaji dhjetor 1986 kur ka filluar punë) dhe paga e bashkëshortes (prej muajit gusht 1989 kur ka filluar punë dhe deri në vitin 2001); (ii) ndihma prej 300.000 lekësh dhënë nga babai i tij, z. Xh.H.; (iii) shitja e apartamentit nr. ***, shkalla ***, pallati ***, lagjja ***, në Kukës, në vlerën 1.000.000 lekë, me kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 6.11.2001, i përfituar nga privatizimi i banesave shtetërore me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 14.1.1994. Pas privatizimit këtë apartament e ka këmbyer me apartamentin nr. ***, shkalla ***, pallati ***, lagjja ***, Kukës (në të njëjtin pallat dhe shkallë), me sipërfaqe të njëjtë, në pronësi të shtetasit S.Ç., me kontratën e këmbimit nr. ***, datë 22.12.1994; (iv) kredi në Bankën Amerikane marrë me kontratën e huas nr. ***, datë 19.6.2002³, në vlerën 7.000 USD, e barabartë me shumën 1.000.000 lekë, me afat 10 vjet.

Në lidhje me të ardhurat nga shitja e apartamentit në Kukës, subjekti i rivlerësimit në deklaratën “Vetting” të vitit 2017 deklaroi se vlera e apartamentit në Kukës është likuiduar paraprakisht në mirëbesim nga shtetasi Z.M., që në muajin tetor 2001, për shkak se këto para i duheshin për të plotësuar shumën për blerjen e apartamentit në Tiranë, pasi apartamentin në

² Kontratë shitblerje (apartament 3+1), nr. ***, datë 2.11.200; kontratë shitje (apartament 3+1) nr. ***, datë 26.10.2001; kontratë shitblerje për pasuri të paluajtshme nr. ***, datë 6.11.2001; bashkëlidhur kontratë shitblerje datë 14.1.1994, me Ndërmarrje Komunale Banesa Kukës; kontratë këmbimi nr. ***, datë 22.11.1994, midis S.Ç., dhe Zeqir Hoda, njësuar me origjinalin me vërtetimin nr. *** rep., datë 20.1.2017; deklaratë noteriale nr. ***, datë 19.1.2017, nga Z.M., për shumën e paguar në vitin 2001; deklaratë nr. *** kol, dt. 5.1.2017, për huadhënien e vitit 2001 në shumën 3.000 usd, nga S.Ç.; deklaratë noteriale nr. ***, datë 28.12.2016, nga A.D., për shumën e dhenë hua në vitin 2001, prej 4.000 USD; vërtetim nga “Raffaisen Bank”, datë 26.1.2017; kontratë huaje nr. ***, datë 19.6.2002, huadhënës Banka Amerikane e Shqipërisë dhe huamarrës Zeqir Hoda dhe N.H.; kontratë hipotekimi nr. ***, datë 19.6.2002.

³ Kontratë hipotekimi nr. ***, datë 19.6.2002.

Kukës nuk mund ta shiste pa gjetur apartamentin në Tiranë. Me tej, subjekti deklaroi se me shtetasin Z.M. ka pasur dhe ka marrëdhënie shoqërore dhe miqësore, si dhe kishin biseduar që apartamentin t'ia shisnin atij, pasi donte ta këmbente me apartamentin e shtetasit Xh.V., që ndodhej ngjitur me farmacinë e tij.

Po në lidhje me këtë apartament subjekti deklaroi se pasi bleu apartamentin në Tiranë (datë 2.11.2001) është kthyer menjëherë në Kukës dhe në datën 6.11.2001 ka bërë kontratën e shitjes së apartamentit me shtetasin Xh.V., i cili i shiti apartamentin e tij shtetasit Z.M. Për të vërtetuar deklarin e tij subjekti ka bashkëlidhur një deklaratë noteriale të shtetasit Z.M., me nr. ***, datë 19.1.2017, pranë noteres V.B., Kukës.

1.6 Në lidhje me kredinë e marrë në Bankën Amerikane, subjekti i rivlerësimit në deklaratën “Vetting 2017” sqaron se fillimisht këtë shumë e ka marrë hua dy të njohurve të tij, pasi për të marrë kredi bankare duhej certifikata e pronësisë së apartamentit për ta vendosur si *kolateral*. Subjekti deklaroi se i ka marrë shumën 3.000 USD shtetasit S.Ç., dhe pjesën tjetër prej 4.000 USD ia ka marrë hua shtetas A.D. Me të dy këta shtetas subjekti deklaroi se ka pasur dhe ka marrëdhënie familjare dhe shoqërore, dhe i kanë dhënë hua në mirëbesim, pa ndonjë akt, pa interes me premtimin se do t'ia kthente sapo të merrte kredinë. Më tej, subjekti deklaroi se shumata e marra hua, ia ka kthyer huadhënësve sapo i është *disbursuar* kredia dhe për këtë ka bashkëlidhur si provë dy deklarata noteriale: (i) të shtetasit S.Ç. me nr. ***, datë 5.1.2017, përpara noterit A.H., Tiranë; dhe (ii) të shtetas A.D., me nr. ***, datë 28.12.2017, përpara noteres A.M. (K.), Tiranë.

1.7 Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, ka sqaruar se në aplikimin që ka bërë në Bankën Amerikane për kredi, ka shpjeguar se kredinë e kërkonte për të likuiduar huan që i kishte marrë dy të njohurve të tij për blerjen e apartamentit. Banka pasi ka bërë verifikimin të këta shtetas, ka miratuar dhënien e kredisë dhe meqë banka nuk jepte kredi për likuidim huaje, në kontratën e huas dokumentoi se kredinë e jepte për financimin e këstit të fundit për blerjen e apartamentit të ri. Në lidhje me deklarin e marrjes së huas në deklaratën e interesave vjetore të vitit 2004, subjekti deklaroi se kur e ka plotësuar për herë të parë deklaratën e pasurisë për vitin 2003, kredinë në “Bankën Amerikane” e ka deklaruar si një nga burimet për blerjen e apartamentit, pa e shtjelluar në mënyrë të detajuar lidhjen e kësaj kredie me huan që u likuidua me këtë kredi, duke qenë se kredia në kontratë dokumentohej se jepej nga banka për likuidimin e këstit të fundit për blerjen e apartamentit të ri dhe në fakt kishte shërbyer për likuidimin e vlerës me të cilën ishte blerë ky apartament e kam deklaruar si një nga burimet për blerjen e apartamentit. Në lidhje me këtë pasuri subjekti ka paraqitur dokumentacionin justifikues për të vërtetuar deklarin e tij në deklaratën “Vetting” të vitit 2017.⁴

⁴ Kontratë shitblerje (apartament 3+1), nr. ***, datë 2.11.2001, çmimi i blerjes 3.900.000 lekë, me palë shitëse A.H., A.H., M.H. dhe M.H. dhe palë blerëse Zeqir Hoda, njësuar me origjinalin me vërtetimin nr. *** prot., datë 20.1.2017; kontratë shitje (apartament 3+1) nr. ***, datë 26.10.2001, me palë shitëse Enti Kombëtar i Banesave dhe palë blerëse A.H., A.H., M.H. dhe M.H., Rr. “*****”, p. ***, sh. ***, ap. ***, k. ***, tip i veçantë, me sip. ndërtimi 106.7 m² dhe sip. shfrytëzimi 92.75 m²; kontratë shitblerje për pasuri të paluajtshme me nr. ***, datë 6.11.2001 me palë shitëse Zeqir Hoda dhe palë blerëse Xh.V. dhe A.V. Vlera e shitjes 1.000.000 lekë, pasuria nr. *** vol. ***, f. ***, apartament me sip. 60 m², lagjja nr. ***, pall. ***, shk. ***, ap. ***. Bashkëlidhur kontratë shitblerjeje datë 14.1.1994, me NKB Kukës, për blerjen e apartamentit nr. ***, shk. ***, p. ***, lagjja ***, në vlerë 10.941 lekë, njësuar me origjinalin me vërtetimin nr. *** rep., datë 20.1.2017; kontratë këmbimi, nr. ***, datë 22.11.1994, midis S.Ç. dhe Zeqir Hoda, njësuar me origjinalin me vërtetimin nr. *** rep., datë 20.1.2017; deklaratë noteriale nr. ***, datë 19.1.2017, nga Z.M., për shumën e paguar në vitin 2001; deklaratë nr. ***, datë 5.1.2017, për huadhënien e vitit 2001 në shumën 3.000 USD nga S.Ç., shumë e cila është likuiduar pasi Zeqir Hoda ka marrë kredinë; deklaratë noteriale nr. ***, datë 28.12.2016, nga A.D., për shumën e dhënë hua në vitin 2001, prej 4.000 USD, shumë e cila është likuiduar pasi Zeqir Hoda ka marrë kredinë; vërtetim nga “Raiffeisen Bank”, datë 26.1.2017, ku vërtetohet se Xh.S.H., ka qenë klienti i ish-Bankës së Kursimeve Dega Kukës, gjatë vitit 1997; kontratë huaje nr. ***, datë 19.6.2002, huadhënës Banka Amerikane e Shqipërisë dhe huamarrës Zeqir Hoda dhe N.H., shuma e huas 7.000 USD; kontratë hipotekimi nr. ***, datë 19.6.2002, si *kolateral* është vendosur “apartament” me sip. 106.7 m², Tiranë, regjistri hipotekor nr. ***, datë 22.11.2001, bashkëlidhur vërtetim pronësie nga dokumenti hipotekor nr. ***, z.k. ***, datë 22.11.2001, njësuar me origjinalin me vërtetimin nr. *** rep., datë 20.1.2017.

1.8 Në deklaratën e interesave private të vitit 2003, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim për blerjen e këtij apartamenti: (i) shitjen e një banese 1+1 në Kukës të përfituar në bazë të ligjit për privatizimin e banesave shtetërore; (ii) kursime familjare; dhe (iii) kredi në Bankën Amerikane në shumën 7.000 USD.

1.9 Komisioni, në lidhje me deklarin e kësaj pasurie, arrin në përfundimin se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacion e administruar gjatë hetimit.

1.10 Komisioni nga hetimi administrativ, **në lidhje me kontrollin e ligjshmërisë së burimit të krijimit të kësaj pasurie** nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur ose të tjerë të lidhur, konstatoi dhe vlerësoi se:

❖ **Për kursimet familjare si burim krijimi në shumën 1.600.000 lekë**

1.11 Me dokumentacionin e administruar nga hetimi administrativ, konfirmohen të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortes për periudhën 1986 – tetor 2001. Për këtë qëllim Komisioni kreu një analizë financiare duke marrë në konsideratë: (i) të ardhurat; dhe (ii) shpenzimet, si më poshtë:

	Përshkrim	Shumat në lekë
1	TË ARDHURA	4.275.259
	Të ardhura nga paga e subjektit dhjetor 1986 – tetor 2001 ⁵	3.026.979
	Të ardhura nga paga e bashkëshortes gusht 1989 - tetor 2001 ⁶	1.248.280
2	SHPENZIME	2.428.580
	Shpenzime jetese ⁷	2.428.580
	DIFERENCA (TË ARDHURA - SHPENZIME 1-2)	+ 1.846.679

1.12 Nga analiza financiare e kursimeve familjare, Komisionit i rezulton se subjekti i rivlerësimit ka pasur të ardhura nga burime të ligjshme për të kontribuar në blerjen e këtij apartamenti në shumën 1.600.000 lekë, referuar dokumentacionit të administruar gjatë hetimit.

❖ **Për shumën 300.000 lekë, deklaruar si ndihmë nga babai i subjektit të rivlerësimit**

1.13 Komisioni i kërkoi subjektit, me anë të pyetësorit nr. 2, të provojë mundësinë financiare të babait të tij për kursimin e vlerës prej 300.000 lekësh.

1.14 Subjekti i rivlerësimit dorëzoi dokumentacion ligjor justifikues⁸, për të vërtetuar se shtetasi Xh.H., ka qenë i punësuar 34 vjet e 8 muaj (sipas fletë llogaritjes së pensionit dhe librezës së punës, ku nuk është marrë parasysh shkëputja 3-vjeçare). Nga dokumentacioni i administruar, rezultoi se babai i subjektit të rivlerësimit ishte trajtuar me pension pleqërie që prej datës 2.10.1994 duke filluar nga 2.200 lekë/muaj.

⁵ Vendim nr. ***, datë 09.08.1986, Komiteti Ekzekutiv Kukës; vendim nr. ***, datë 2.9.1986, emërim dhe lëvizje kuadri; vërtetim i RTSH-së, Drejtorja e Radio Kukësi, nr. ***, datë 24.10.2016; vërtetim për vjetërsi pune Drejtorja Rajonale Kukës nr. ***, datë 12.10.2016, periudha 1.4.1988 –15.8.1993; vërtetim i ISSH-së, Drejtorja Rajonale Kukës nr. ***, datë 12.10.2016; vërtetim i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kukës, nr. ***, datë 21.10.2016.

⁶ Vërtetim DRSSH-ë Kukës për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare, nr. *** prot, dt. 19.1.2017

⁷ Në mungesë të të dhënave, për vitet 1986 – 1996 u konsideruan si shpenzime jetese 80% e të ardhurave. Për vitet 1997–2001, i referohet publikimit nga INSTAT për konsumin për frymë anketa e matjes së nivelit të jetesës 2002-2005-2008, f. 6, ku në vitin 2002 është vlerësuar me 7.801 lekë/muaj.

⁸ Dokumentacioni i dorëzuar përfshin: fletë përlllogaritje pensioni Xh.S.H.; vendim për caktim pensioni nr. *** datë 18.10.1994; vërtetim page për punonjësin Xh.S.H., 1 shkurt 1990 - 30 janar 1993; librezë e punës e shtetasit Xh.H., dy fletë (fotokopje); vërtetim datë 26.1.2017, i lëshuar nga “Raiffeisen Bank”; vendim mbi daljen në pension, nr. ***, datë 3.1.1992, e P.D.H., (nëna e subjektit).

1.15 Komisionit, bazuar në faktet e sipërpërmendura nga hetimi administrativ, i rezultoi se nuk ka dorëzuar dokumentacion ligjor justifikues për të ardhurat e realizuara nga blegtoria pas vitit 1994 dhe ndihma e dhënë nga fëmijët emigrantë.

1.16 Në drejtim të dyshimit mbi aftësinë financiare të babait të subjektit të rivlerësimit, duke e lidhur këtë dyshim jo vetëm me verifikimin e saktësisë dhe vërtetësisë së deklarimit të subjektit, por edhe në drejtim të vlerësimit të mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme të babait të tij, për të kursyer këtë shumë, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

1.17 Subjekti i rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës deklaroi se të ardhurat e babait të tij janë akumuluar si rezultat i punësimit për rreth 31 vjet, trajtimit me pension pleqërie, të ardhurat nga ekonomia bujqësore dhe blegtorale, si dhe ndihma e fëmijëve emigrantë. Një analizë e tillë e plotë provon faktin që i ati ka pasur një jetë shumë aktive pune dhe ka mundur të sigurojë një të ardhur minimale prej 300.000 lekësh për të përmbushur detyrimin prindëror. Z. Xh.H., ka qenë klient i ish-Bankës së Kursimeve, dega Kukës gjatë vitit 1997 dhe sipas vërtetimit datë 23.1.2017, të lëshuar nga “Raiffeisen Bank”, konfirmohet se z. Xh.H., ka qenë klient i kësaj banke. Për të provuar shpjegimet e tij subjekti dorëzoi dokumentacion ligjor provues⁹

1.18 Nga analizimi i shpjegimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, rezulton se babai i subjektit, i ndjeri Xh.H., rezulton të ketë pasur mundësi financiare të ligjshme për shumën prej 300.000 lekësh.

1.19 **Komisioni vlerëson** se shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës, provojnë se prindërit e tij, kanë pasur burime të mjaftueshme të ardhurash për të kursyer shumën prej 300.000 lekësh, të siguruara në mënyrë të ligjshme nga puna mbi 31 vjeçare e dokumentuar në pozicionet kuzhinier, kamerier dhe banakier; të ardhurat e siguruara nga pensionet e pleqërisë së prindërve; të ardhurat e siguruara nga prodhimet bujqësore dhe blegtorale; si dhe ndihma ekonomike e fëmijëve emigrantë.

❖ **Për të ardhurat prej 1.000.000 lekësh që janë krijuar nga shitja e apartamentit në Kukës**

1.20 Me anë të kontratës nr. ***, datë 6.11.2001, midis Zeqir Hoda palë shitëse dhe Xh.V., dhe A.V., palë blerëse, është bërë shitja e kësaj banese (të përfituar në bazë të ligjit për privatizimin e banesave shtetërore) në vlerën 1.000.000 lekë, e likuiduar jashtë zyrës së noteriale.

1.21 Nga verifikimi i datave të dy kontratave, asaj të shitjes në Kukës dhe kontratës së shitblerjes për apartamentin në Tiranë ka një mospërputhje në data, për të cilat subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime në deklaratën “Vetting” dhe gjatë hetimit. Ai deklaroi se vlera e apartamentit në Kukës është likuiduar paraprakisht në mirëbesim nga shtetasi Z.M., që në muajin tetor 2001, pagesë e cila do të përdorej për të plotësuar shumën për blerjen e apartamentit në Tiranë. Subjekti deklaroi se ka marrëdhënie shoqërore dhe lidhje miqësore me shtetasin Z.M., i cili këtë apartamentin do ta këmbente me apartamentin e shtetasit Xh.V., pasi ndodhej ngjitur me farmacinë e tij.

⁹ Deklaratë noteriale nr. ***, datë 25.06.2019, deklarues P.H.; vërtetim nga ZVPPP-ja Kukës, datë 22.04.2002 dhe datë 16.08.2012, të pronësisë së tokave bujqësore të Xh.H. dhe fotografi ku janë të fiksuara momentet e punës në bujqësi të prindërve të subjektit të rivlerësimit; vërtetim nr. *** prot., datë 19.06.2019, nga Drejtoria Rajonale Sigurimeve Shoqërore Kukës për P.H., ku vërtetohet se gjatë periudhës 6.6.1991 – 31.10.2001 shuma e pensionit të pleqërisë ka qenë 117.066 lekë; vërtetim nr. *** prot., datë 19.6.2019 Drejtoria Rajonale Sigurimeve Shoqërore Kukës për Xh.H., ku vërtetohet se gjatë periudhës 2.10.1994 – 31.10.2001 shuma e pensionit të pleqërisë ka qenë 344.976 lekë; deklaratë noteriale nr. ***, datë 25.6.2019, deklarues V.H.; deklaratë noteriale nr. ***, datë 25.6.2019, deklarues A.H.; deklaratë noteriale nr. ***, datë 25.6.2019, deklarues Y.H.; deklaratë noteriale nr. ***, datë 21.06.2019, deklarues S.M.; certifikatë e historikut të vendbanimit, nr. ***, I.M.; certifikatë e historikut të vendbanimit, nr. ***, S.M.; deklaratë noteriale nr. ***, datë 21.06.2019, deklarues M.H.; deklaratë noteriale nr. ***, datë 21.06.2019, deklarues M.H.

1.22 Në dokumentacionin e dorëzuar bashkë me deklaratën “Vetting”, subjekti paraqiti një deklaratë noteriale nga shtetasi Z.M., të datës 19.1.2017, i cili në lidhje me shitjen e apartamentit të blerë në datën 6.11.2001, deklaroi se Zeqir Hoda i kishte kërkuar që t’i likuidonte vlerën e apartamentit në Kukës, pasi i duheshin paratë menjëherë, duke qenë se kishte gjetur një apartament të përshtatshëm në Tiranë. Subjekti sapo ishte kthyer nga Tirana, kishte bërë kontratën e shitblerjes së apartamentit të tij në Kukës me shtetasin Xh.V., të cilit Z.M., i bleu apartamentin që kishte ngjitur me farmacinë e tij në Kukës.

1.23 Pra, subjekti i rivlerësimit pasi në datë 2.11.2001, bleu apartamentin në Tiranë dhe në datë 6.11.2001, lidhi kontratën e shitjes së apartamentit me shtetasin Xh.V., ky i fundit, i shiti¹⁰ apartamentin e tij shtetasit Z.M.

1.24 Në përpunim të sa më lart, Komisionit i rezultoi se ka mospërputhje të datë së blerjes së shtëpisë në Tiranë me atë të shitjes së shtëpisë në Kukës.

1.25 Komisioni, pasi hetoi dhe shqyrtoi dokumentacionin e administruar, vlerëson se subjekti i rivlerësimit shpjegoi bindshëm dhe provoi se të ardhurat e shtëpisë në Kukës kanë shërbyer si burim për blerjen e shtëpisë në Tiranë, në shumë 1.000.000 lekë.

1.26 Në lidhje me konstatimin se subjekti i rivlerësimit ka blerë shtëpinë në Tiranë 2 ditë para se të shiste shtëpinë në Kukës, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit shpjegoi bindshëm se ai kishte njohje me z. Z.M., dhe ai ia kishte dhënë lekët paraprakisht në mirëbesim, me qëllim që të blinte apartamentin në Tiranë. Gjithashtu, Komisioni çmon se fakti që subjekti i rivlerësimit i ka deklaruar këto të ardhura si burim krijimi që në deklaratën e vitit 2003, për herë të parë, si dhe fakti që subjekti ka dhënë shpjegime shtesë në deklaratën “Vetting” në lidhje me këtë mospërputhje, krijojnë bindjen se ai ka qenë i saktë dhe i plotë në deklaratimet e tij.

❖ Në lidhje me huan e marrë në “Bankën Amerikane” në shumën 7.000 USD

1.27 Në deklaratën “Vetting” subjekti i rivlerësimit shpjegon se lidhur me kredinë në “Bankën Amerikane”, këtë shumë fillimisht e ka marrë hua nga dy të njohurit e tij, pasi për të marrë kredi bankare duhej vendosur si *kolateral* certifikata e pronësisë së apartamentit.

1.28 Shtetasi S.Ç., me të cilin ka deklaruar se ka marrëdhënie shoqërore, i ka marrë hua 3.000 dollarë, në mirëbesim, pa ndonjë akt noterial dhe pa interes. Kjo hua, është likuiduar sapo është *disbursuar* kredia¹¹. Shtetasi A.D., me të cilën ka deklaruar se ka njohje familjare dhe marrëdhënie shoqërore, i ka marrë hua në mirëbesim, pa ndonjë akt, pa interes, shumën prej 4.000 dollarë. Kjo hua është likuiduar sapo është *disbursuar* kredia¹².

1.29 Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se në aplikimin e bërë në “Bankën Amerikane” për kredi ka sqaruar se kredinë e kërkonte për të likuiduar huan e marrë për blerjen e apartamentit. Banka pasi ka bërë verifikimet përkatëse të këta shtetas ka miratuar dhënien e kredisë. Duke qenë se banka nuk jepte kredi për likuidim huaje, në kontratën e huas, është dokumentuar se kjo kredi është dhënë për financimin e kështit të fundit për blerjen e apartamentit.

1.30 Më tej, subjekti sqaroi se në deklaratën e pasurisë të vitit 2003, kredinë në “Bankën Amerikane” e ka deklaruar si një nga burimet për blerjen e apartamentit, por pa e shtjelluar në mënyrë të detajuar lidhjen e kësaj kredie me huatë e likuiduara. Duke qenë se në kontratën e kredisë dokumentohej se kjo kredi jepej për pagesën e kështit të fundit për blerjen e apartamentit, dhe në fakt kishte shërbyer për likuidimin e vlerës me të cilën ishte blerë ky apartament, prandaj subjekti i rivlerësimit e kishte deklaruar si një nga burimet për blerjen e tij.

¹⁰ Deklarata noteriale, nr. ***, datë 19.1.2017, e shtetasit Z.M.

¹¹ Deklarata noteriale, nr. ***, datë 5.1.2017, e shtetasit S.Ç.

¹² Deklarata noteriale, nr. ***, datë 28.12.2017, e shtetasit A.D.

1.31 Nga dokumentacioni i administruar nga “Intesa Sanpaolo Bank” (ish-Banka Amerikane), konstatohet se në datën 8.7.2002 është *disbursuar* në llogarinë e subjektit të rivlerësimit, shuma prej 7.000 USD, me përshkrimin kredi e re, siç edhe subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar.

1.32 Duke qenë se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka marrë 2 hua, deri në momentin që i është *disbursuar* kredia nga Banka Amerikane, Komisioni bazuar në nenin 32, të ligjit nr. 84/2016, i kërkoi subjektit të rivlerësimit që të dërgonte dokumentacion justifikues ligjor për të ardhurat e ligjshme të të dy huadhënësve të konfirmuar nga subjekti i rivlerësimit dhe vetë huadhënësit. Nga ky hetim rezultoi se:

❖ **Në lidhje me huan prej 3.000 USD nga shtetasi S.Ç.**

1.33 Për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të huas subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se shtetasi S.Ç., është marrë me aktivitetin e ndërtimit në periudhën 1994 – 2004 si administrator i shoqërisë “***” sh.p.k., e cila rezultoi të jetë mbyllur në vitin 2004.¹³ Për të vërtetuar deklarimin e tij, ndër të tjera, subjekti ka depozituar vërtetimin për bazën e vlerësueshme me nr. *** prot., datë 18.0.2019, të z. S.Ç., për periudhën 1994 – 2002, ku vërtetohet se paga bruto si administrator i shoqërisë është në total në shumën 1.078.500 lekë për periudhën 1994 – tetor 2001¹⁴. Ndërkohë, referuar hetimit të kryer nga Komisioni, sipas shkresës nr. *** prot., datë 5.6.2019, nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, për huadhënësin S.Ç., dhe bashkëshorten e tij B.Ç., nuk disponohen të dhëna.

Në përgjigje të kërkesës së Komisionit, Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë, me shkresë nr. *** prot., datë 5.6.2019 informon se subjekti “***” sh.p.k., i regjistruar me NIPT ***, me aktivitet ndërtim, me administrator z. S.C., është regjistruar në datën 29.1.2004 dhe është çregjistruar në sistemin tatimor në datën 21.5.2004. Në sistem nuk ka të dhëna për të ardhurat e realizuara, ndërsa në arkiv nuk ka asnjë dokument apo bilanc të dorëzuar.

Gjatë hetimit administrativ për shoqërinë “***” sh.p.k., në sistemin *online* të QKB-së nuk figuroi asnjë e dhënë, pasi kjo shoqëri është likuiduar në datën 12.5.2004 (përpara krijimit të QKR-së). Subjekti nuk ka dorëzuar asnjë informacion lidhur me të ardhura të tjera që shtetasi S.Ç. siguronte nga kjo shoqëri, përveç pagave.

1.34 **Nga hetimi administrativ u konstatua se** duke konsideruar vetëm shpenzime jetike për një person e duke mos marrë parasysh ndalesat për tatimin mbi të ardhurat; sigurime shoqërore dhe shëndetësore, shtetasi S.Ç., nuk ka pasur mundësi të kursejë shumën prej 3,000 USD, vetëm me të ardhurat nga pagat, shumë e cila i është dhënë hua subjektit të rivlerësimit.

1.35 Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, deklaroi se shtetasi S.Ç., siguronte të ardhura të ligjshme nga aktiviteti i biznesit që menaxhonte si administrator i shoqërisë “***” sh.p.k., si dhe ka pasur të ardhura të ligjshme për të krijuar rezervën monetare prej 3,000 USD, cilat i kishte siguruar nga shitja e dy apartamenteve të banimit që ka pasur në pronësi në qytetin e Kukësit, vlera e siguruar rezultoi të jetë 33.000 marka gjermane. Këtë fakt subjekti e provoi me kontratat e shitblerjes nr. ***, datë 27.9.1999 dhe nr. ***, datë 27.09.1999.

Gjithashtu, subjekti paraqiti vërtetimin origjinal për bazën e vlerësueshme të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Kukës për z. S.Ç., dhe znj. B.Ç., ku vërtetohet se kjo e fundit ka qenë në marrëdhënie pune prej vitit 1987 deri në vitin 2001. *Subjekti, për të provuar shpjegimet e tij, dorëzoi dokumentacion ligjor provues*¹⁵.

¹³ Dokumentacioni i dorëzuar përfshin: vendimi nr. ***, datë 26.04.2004, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; vendimi nr. ***, datë 12.09.2004, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; vërtetim për bazën e vlerësueshme nr. *** prot., datë 18.02.2019, e S.Ç. për vitet 1994 – 2002.

¹⁴ Sipas përlllogaritjeve të Komisionit pagat neto rezultojnë të jenë në shumën 999.333 lekë.

¹⁵ Kontratat e shitblerjes nr. ***, datë 27.9.1999 dhe nr. ***, datë 27.9.1999; vërtetimi për bazën e vlerësueshme nr. *** prot., datë 18.6.2019, të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Kukës për znj. B.Ç.; vendimi nr. ***, datë 26.4.2004 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë;

1.36 Pas shqyrtimit të dokumentacionit të dërguar nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit provoi vetëm në mënyrë deklarative që kishte marrë hua nga z. S.Ç., por nuk provoi se kishte burime të ligjshme për të krijuar shumën e dhënë hua.

❖ **Në lidhje me huan prej 4,000 USD nga shtetasja A.D.**

1.37 Për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të huas, në përgjigje të pyetësorit të Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka depozituar dokumentacion justifikues nga znj. A.D. për periudhën 1994 – tetor 2001: (1) Sipas kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 14.8.2000, rezulton që shtetasit A.D., dhe N.D., kanë shitur një apartament me vlerën 300.000 lekë; (2) vërtetimi nr. ***, datë 18.2.2019, i Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Kukës, për pagat bruto të shtetasës A.D. Ndërkohë, referuar hetimit të kryer nga Komisioni, referuar shkresës nr. *** prot., datë 5.6.2019, të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, për huadhënësen A.D., dhe bashkëshortin e saj N.D., nuk disponohen të dhëna.

1.38 **Komisionit bazuar në faktet e sipërpërmendura nga hetimi administrativ**, duke konsideruar të ardhurat nga apartamenti dhe mundësinë për kursim gjatë periudhës 1994 – 2000, dhe gjithashtu duke konsideruar shpenzime jetike vetëm për një person, dhe duke mos marrë parasysh ndalesat për tatimin mbi të ardhurat, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, konstaton se shtetasja A.D., nuk ka pasur mundësi të kursejë shumën totale prej 4.000 USD të dhëna hua. Subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

1.39 Subjekti i rivlerësimit në datën 20.6.2019, paraqiti para Komisionit kërkesën për marrjen në pyetje të shtetasës A.D., në cilësinë e dëshmitares, lidhur me burimet e krijimit të shumës 4.000 USD dhënë hua subjektit, kërkesë e cila u pranua nga Komisioni.

1.40 Subjekti i rivlerësimit, dorëzoi deklaratën noteriale nr. ***, datë 19.6.2019, të znj. A.D., e cila deklaroi se përveç të ardhurave që kishte siguruar nga shitja e apartamentit në Kukës, ajo dispononte edhe të ardhurat që kishte siguruar në vitet 1998 –1999 nga qiraja e apartamentit për një periudhë 2 muaj, të dhënë 3 gazetarëve të huaj, të cilët kanë qëndruar gjatë periudhës së luftës në Kosovë. Prej qirasë së apartamentit ajo kishte siguruar vlerën prej 4.500 USD. Subjekti i rivlerësimit, paraqiti një deklaratë me shkrim dore, lëshuar nga znj. A.D., në datën 9.11.2002, ku ajo deklaroi se me këtë datë, subjekti i ka kthyer shumën 4.000 USD, që i kishte marrë borxh. Znj. A.D., pohoi të njëjtat deklaratime gjatë marrjes në pyetje si dëshmitare para Komisionit.

Subjekti gjithashtu dorëzoi vërtetimin për bazën e vlerësueshme nr. *** prot., datë 18.4.2019, të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Kukës, për z. N.D., (bashkëshorti i znj. A.D.), ku provohet marrëdhënia e punës nga viti 1984 deri në qershor të vitit 2000. Ndërkohë që vetë zonja A.D., gjatë dëshmisë së saj deklaroi se ajo ka jetuar vetëm sepse bashshorti gjatë kësaj periudhe jetonte dhe punonte në Angli. Ai kishte të ardhura dhe kursime nga puna, por ishte në kushtete e pamundësisë për t'i provuar, pasi Z. N.D., ka ndërruar jetë.

1.41 **Komisioni krijoi bindjen se provat e administruara gjatë hetimit, provate e reja të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe dëshmia e znj. A.D., të interpretuara në harmoni me njëra tjetrën, krijojnë bindjen dhe vërtetojnë se huadhënësja A.D., ka pasur burime të mjaftueshme për të krijuar rezervën prej 4.000 USD, dhënë subjektit të rivlerësimit në formën e huas në vitin 2001 për blerjen e apartamentit.**

vendimi nr. ***, datë 12.9.2004, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; vërtetim për bazën e vlerësueshme nr. *** prot., datë 18.2.2019, nga S.Ç., për periudhën 1994 – 2002; deklaratata noteriale e shtetasit S.Ç., nr. ***, datë 5.1.2017.

2. Autoveturë, marka “Daimler Chrysler”, me targa ***

a. Komisioni, për vërtetimin e faktit, administroi:

2.1 Deklaratën “Vetting” të vitit 2017 dhe dokumentacion ligjor provues.¹⁶

2.2 Dokumentacionin e DPRRTSH-së të administruar në ILDKPKI.

2.3 Dokumentacionin e administruar nga bankat dhe vërtetimet e pagave.

b. Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me ligjin e zbatueshëm

2.4 Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se disponon autoveturë, marka “Daimler Chrysler”, blerë me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 29.1.2014, në shumën 7,000 euro. Pjesa takuese: në bashkëpronësi me familjen në pjesë të barabartë.

2.5 Si burim krijimi, subjekti deklaroi se kanë shërbyer kursimet e mbledhura nga paga e subjektit dhe e bashkëshortes për periudhën 2004 - 2013.

2.6 Nga hetimi administrativ u konstatua se referuar deklaramit në deklaratën e interesave private vjetore të vitit 2014 kjo pasuri është blerë me të ardhura duke pakësuar gjendjen *cash* të deklaruar më parë.

2.7 Komisioni kreu analizën financiare për pasuritë, për të ardhurat, shpenzimet dhe detyrimet e subjektit dhe të personave të lidhur, dhe arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaramit të saktë dhe në përputhje me ligjin, si dhe ka burime financiare me dokumentacion justifikues për blerjen e këtij automjeti.¹⁷

3. Apartament banimi, me sip. 108.02 m², Rruga *, pranë Zogut të Zi, Tiranë.**

a. Komisioni, për vërtetimin e faktit, administroi:

3.1 Deklaratën “Vetting” të vitit 2017 dhe dokumentacionin bashkëlidhur.¹⁸

3.2 Provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja dhe Komisioni.

3.3 Dokumentacionin e administruar nga ZVRPP-ja Tiranë¹⁹.

b. Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me ligjin e zbatueshëm

3.4 Në deklaratë “Vetting” të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit deklaroi se ka në pronësi një apartament banimi (2+1), me sip. 108.02 m², nga të cilat sipërfaqe fizike 96.48 m² dhe sipërfaqe të përbashkët 11.54 m², me adresë: Rruga ***, pranë Zogut të Zi, kati ***, Tiranë.

3.5 Si burim krijimi subjekti deklaroi se kanë shërbyer: (i) vlera 20.000 euro (2.800.000 lekë) krijuar nga kursimet e mbledhura nga paga e subjektit dhe e bashkëshortes për periudhën 2004 – 2014; dhe (ii) vlera 6.700.000 lekë kredi në Bankën Kombëtare Tregtare²⁰.

¹⁶ Kontratë shitblerjeje automjeti nr. ***, datë 29.1.2014; autoveturë e llojit “Daimler Chrysler”, me targa ***, me nr. shasie ***, me çmim 7.000 euro. Njësuar me origjinalin me vërtetimin nr. *** rep., datë 20.1.2017; leje qarkullimi nr. ***, në emër të Zeqir Hoda, për automjetin me targa ***, me nr. shasie ***; bashkëlidhur certifikata e pronësisë së mjetit.

¹⁷ Referojuni analizës financiare në pikën V/3, pika 10.

¹⁸ Kontratë porosie nr. ***, datë 26.2.2015; apartament me sip. të përgjithshme 108.02 m², nga të cilat fizike 96.48 m² dhe sip. të përbashkëta 11.54 m², me përbërje 2+1, k. ***, shk. ***, në vlerë 75.000 euro, të cilat do likuidohen: kësti i parë prej 20.000 euro, do të likuidohet me nënshkrimin e kësaj kontrate; kësti i dytë prej 50.000 euro, do të likuidohet në momentin e çeljes së kredisë bankare; kësti i tretë prej 5.000 euro, do të likuidohet me nënshkrimin e kontratës së shitblerjes së apartamentit. Njësuar me origjinalin me vërtetimin nr. *** rep., datë 20.1.2017; faturë derdhjeje në “Credins Bank”, datë 23.3.2015, e shumës 20.000 euro, në favor të “****” për kontratën nr. ***, kontratë hipotekimi nr. ***, datë 24.4.2015, si *kolateral* është vendosur apartament me sip. 92.70 m², nr. pasurie ***, z.k. ***, Rr. “****”, nd. ***, h. ***, ap. ***, Tiranë; kontratë kredie bankare nr. ***, datë 24.4.2015, në shumën 6.700.000 lekë, bashkëlidhur Aneks i Çeljes dhe përdorimit të kredisë datë 24.4.2015, kredia do të përdoret nga kredimarrësi për blerje apartamenti, njësuar me origjinalin me vërtetimin nr. *** rep., datë 20.1.2017; *statement* i llogarisë nga “BKT”, datë 4.5.2015, ku vërtetohet *disbursim* kredie në datën 29.4.2015, në shumën 6.700.000 lekë dhe transferim i kësaj shume po në datën 29.4.2015, në favor të “****” sh.p.k., për likuidim blerje apartamenti sipas kontratës së kredisë nr. ***, datë 24.4.2015.

¹⁹ Shkresa nr. ***, datë 25.4.2018.

²⁰ Kontratë kredie bankare nr. ***, datë 24.4.2015, kredimarrës subjekti dhe bashkëshortja e tij, për marrjen e kësaj kredie është lidhur kontratë hipotekimi në favor të “BKT”-së Laç, nr. ***, datë 24.4.2015, me objekt hipotekimi apartament me nr. pasurie ***, në z.k. *** me adresë: Rr. “****”, nd. ***, h. ***, ap. ***, Tiranë (apartamenti ku subjekti banon), hipotekues subjekti dhe bashkëshortja.

3.6 Nga hetimi administrativ u konstatua se ky apartament është porositur nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij me shoqërinë “***” sh.p.k., me çmim 75.000 euro. Në kontratën e porosisë likuidimi i vlerës së apartamentit është parashikuar të bëhet në këtë mënyrë: (i) vlera 20.000 euro do të likuidohet me nënshkrimin e kontratës së porosisë; (ii) vlera 50.000 euro do të likuidohet me kredi në momentin e çeljes së kredisë; dhe (iii) vlera 5.000 euro do të likuidohet me nënshkrimin e kontratës së shitblerjes.

3.7 Nga dokumentacioni i administruar nga shoqëria “***” sh.p.k., si dhe nga dokumentacioni i dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI, konstatohet se depozitimi i shumës 20.000 euro në “Credins Bank”, në emër të shoqërisë sipërmarrëse “***” sh.p.k., për të paguar këstin e parë është kryer nga znj. V.A., në datën 23.3.2015.

3.8 ZVRPP-ja me shkresën nr. ***, datë 25.4.2018, konfirmon se subjekti i rivlerësimit, z. Zeqir Hoda, ka në bashkëpronësi me bashkëshorten, znj. N.H., këtë apartament të porositur me kontratën e porosisë nr. ***, datë 26.2.2015, të shoqëria “***” sh.p.k. dhe me shkresën nr. ***, datë 08.5.2018, vërteton nënshkrimin e kontratës së shitjes nr. ***, datë 5.12.2017, për blerjen e të njëjtit apartament të porositur.

3.9 Shoqëria “***” sh.p.k. me shkresën nr. *** prot., datë 12.3.2019, konfirmon kontratën e porosisë dhe të shitjes në vitin 2017, si edhe konfirmon likuidimin e çmimit të kontratës së porosisë, duke bashkëlidhur dokumentacionin e pagesës²¹.

3.10 Në seksionin e detyrimeve financiare, në deklaratën “Vetting 2017”, subjekti i rivlerësimit deklaroi se shuma e detyrimit financiar që ka mbetur e pashlyer deri në datën e fillimit të rivlerësimit është 5.000 euro + 300.000 lekë.

3.11 Nga analizimi i deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në raport me dokumentacionin u konstatua se ka një mospërputhje midis deklaratës së subjektit në deklaratën “Vetting”, me deklarin e bërë në deklaratën periodike vjetore të vitit 2017, në lidhje me detyrimin e mbetur firmës ndërtuese “***” sh.p.k.

3.12 Në lidhje me këtë mospërputhjen për shumën e detyrimit ndaj firmës “***” sh.p.k., u pyet subjekti, i cili deklaroi se shuma 300.000 lekë e deklaruar nuk rezulton të jetë e parashikuar në kontratën e porosisë, pasi përbën diferencën e mbetur nga shuma 50.000 euro (e konvertuar me kursin e kohës në shumën 7.000.000 lekë), që ishte parashikuar në kontratën e porosisë për t’u likuiduar me kredi bankare në favor të “***” sh.p.k., por ndërkohë “BKT”-ja i miraton kredi në shumën 6.700.000 lekë²². Kjo kredi është *disbursuar* në datën 29. 4.2015, në llogarinë rrjedhëse të pagës së subjektit dhe prej aty është kaluar në llogarinë e shoqërisë “***” sh.p.k. Në këtë mënyrë për shkak të mos mbulimit me kredi të vlerës së plotë prej 7.000.000 lekësh (50.000 euro), siç ishte parashikuar në kontratën e porosisë, subjekti kishte rezultuar me detyrimin prej 300.000 lekësh ndaj “***” sh.p.k.

3.13 Subjekti i rivlerësimit, në seancën dëgjimore të datës 4.7.2019, shpjegoi, më tej, se shuma prej 300.000 lekësh është kompensuar me shpenzime të kryera nga subjekti i rivlerësimit për punime në apartament në vitin 2015 dhe për shpenzime noteriale dhe hipotekore në vitin 2017, shpenzime të cilat duhet të ishin kryer nga shoqëria “***” sh.p.k.²³. Detyrimi i kështit të fundit prej

²¹ Mandatdepozitimi në llogarinë e “***” sh.p.k., në “Credins Bank”, shuma 20.000 euro; lëvizja e llogarisë bankare së “***” sh.p.k., në “BKT”, ku evidentohet shuma 6.700.000 lekë e transferuar nga subjekti i rivlerësimit; mandatarkëtimi nr. ***, datë 4.12.2017, në shumën 5.000 euro, arkëtuar nga subjekti i rivlerësimit, bashkëlidhur ndodhet edhe procesverbal nr. ***, datë 30.12.2015, shuma 1.090 euro; vërtetim pagese nga notere Xh.B., për veprime noteriale, shuma 145.200 lekë arkëtuar nga N.H.

²² “BKT”-ja, me shkresën nr. ***, datë 25.4.2018, ka konfirmuar marrjen e një kredie nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij, në vlerën 6.700.000 lekë, të cilat janë transferuar me transfertë bankare të shoqëria sipërmarrëse “***” sh.p.k.

²³ Në përgjigjen e “***” me shkresë nr. ***, datë 12.3.2019, në dokumentacionin e likuidimit, ndodhet edhe procesverbali nr. ***, datë 30.12.2015, shuma 1.090 euro dhe vërtetim pagese nga notere Xh.B., për veprime noteriale, shuma 145.200 lekë arkëtuar nga N.H. Pagesa prej 145.200 lekësh është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën periodike vjetore të vitit 2017.

5.000 euro është likuiduar në dhjetor të vitit 2017, kur është bërë edhe kontrata e shitblerjes së këtij apartamenti, dhe në deklaratën periodike për vitin 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar likuidimin e këtij detyrimi dhe të gjithë detyrimit ndaj “***” sh.p.k. sipas kontratës së porosisë.

3.14 Si përfundim, Komisioni në lidhje me këtë deklaram vlerëson se subjekti i rivlerësimit arriti të shpjegojë bindshëm arsyet e mospërputhjes dhe provoi me dokumentacion provues se kjo shumë është kompensuar me shpenzimet për punime në apartament dhe shpenzime noteriale, të cilat ishin parashikuar në kontratë si përgjegjësi e firmës ndërtuese.

Në lidhje me analizimin e burimit të ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie

3.15 Likuidimi i shumës 20.000 euro në vitin 2015 e krijuar nga kursimet e mbledhura nga paga e subjektit dhe e bashkëshortes për periudhën 2004 – 2014.

3.16 Komisioni për të vërtetuar këtë deklaram të subjektit të rivlerësimit, kreu analizën financiare duke marrë në konsideratë të ardhurat, pasuritë, shpenzimet jetike sipas ILDKPKI-së, shpenzimet për udhëtime jashtë Shqipërisë sipas sistemit *TIMS*, shpenzime të tjera dhe detyrimet e subjektit dhe të personave të lidhur, siç përshkruhen në tabelën më poshtë:

Tabelë përmbledhëse e rezultateve financiare vjetore për periudhën 2004 – 2015

Viti	Të ardhurat	Pasuri	Shpenzime jetese ILDKPK	Shpenzime për udhëtime nga sistemi <i>TIMS</i>	Shpenzime të tjera ²⁴	Detyrimet	Diferenca për shpenzime
2004	1,589,751	201,823	375,456	150,147	43,387	- 125,091	693,848
2005	1,684,965	845,782	438,228	433,353	34,112	- 147,533	- 214,043
2006	1,746,458	829,591	438,228	249,139	17,687	- 147,153	64,659
2007	1,791,800	811,311	696,288	371,621	3,367	- 83,541	- 174,328
2008	1,521,334	358,432	546,480	338,224	171,400	-	106,798
2009	1,734,738	74,812	409,860	292,995	382,921	-	574,150
2010	1,825,415	124,973	409,860	416,600	300,000	-	573,982
2011	1,820,288	- 82,914	409,860	577,604	665,300	-	250,438
2012	2,010,407	198,326	423,072	327,809	450,000	-	611,200
2013	2,042,326	421,405	423,072	201,924	569,900	46,600	472,625
2014	2,413,061	1,020,182	659,994	264,872	350,000	- 46,600	71,414
2015	3,353,551	7,852,539	672,828	233,744	906,935	6,314,133	1,637
TOTAL	23,534,094	12,656,262	5,903,226	3,858,032	3,895,009	5,810,816	3,032,381

3.17 Në përfundim të analizimit të të dhënave nga hetimit dhe shqyrtimi i dokumentacionit të dërguar nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni vlerëson se referuar nivelit të shpenzimeve jetike të përdoruar nga ILDKPKI-ja me shkresën nr. *** prot., datë 4.3.2019, subjekti i rivlerësimit ka mungesë burimesh të ligjshme për vetëm 2 vjet. Për vitin 2005 ka një diferencë në vlerën prej - 214,043 dhe për vitin 2007 ka një mungesë prej 174,328.

4. Aksione në “*” sh.a, blerë në vitin 2008, nga subjekti dhe bashkëshortja e tij**

a. Komisioni për vërtetimin e faktit administroi:

²⁴ Shpenzime shkollimi për fëmijët, për interesa dhe shpenzime të tjera për kreditë, për punime ndërtimi, shpenzime për blerje pajisjesh elektroshtëpiake.

4.1 Deklaratën “Vetting” të vitit 2017 dhe dokumentacionin bashkëlidhur.²⁵

4.2 Provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja dhe Komisioni.

4.3 Dokumentacionin e administruar nga “***” dhe Agjencia e Prokurimit Publik.²⁶

b. Arsytimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me ligjin e zbatueshëm

4.4 Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit deklaroi se: (i) ka blerë aksione në “***” në vitin 2008, si familjar i punonjësit (bashkëshortja), në këtë shoqëri, në momentin e privatizimit, në shumën 50.000 lekë, në bashkëpronësi të familjes; (ii) personi i lidhur/bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit deklaroi se ka blerë aksione në “***” sh.a, në vitin 2008, si punonjëse në këtë shoqëri, në momentin e privatizimit, në shumën 50.000 lekë, në bashkëpronësi të familjes.

Nga hetimi administrativ kryesisht, u konstatua se:

4.5 Shoqëria “***” me shkresën nr. *** prot., datë 26.12.2017, konfirmon se duke filluar nga data 23.4.2009, shtetasit Zeqir dhe N.H., janë regjistruar në regjistrin e aksioneve të shoqërisë “***”, përkatësisht me 50 aksione, me vlerë 50.000 lekë. Nga momenti i fitimit të titullit të pronësisë mbi aksionet e shoqërisë, deri në datën e kësaj shkrese, në të gjitha mbledhjet e asamblesë së aksionerëve është vendosur mos shpërndarja e *dividentit*.

4.6 Agjencia e Prokurimit Publik me shkresën nr. *** prot., datë 27.12.2017, konfirmon se Zeqir dhe N.H., nuk janë të regjistruar në sistemin *SPE* dhe për pasojë nuk kanë marrë pjesë në ndonjë procedurë prokurimi elektronik për periudhën deri në datën 25.1.2017. Rezulton se nga data 3.6.2014 deri më 25.1.2017, shoqëria “***” ku subjekti Zeqir Xh. Hoda dhe bashkëshortja e tij N.S.H., janë aksionerë me 50 aksione secili është shpallur fituese dhe ka lidhur në total 113 kontrata me institucione të ndryshme publike

4.7 Referuar ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, me ligjin nr. 44/2014, datë 24.4.2014, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005” në pikën 1, të nenit 21 përcaktohet: *“Asnjë individ, kur ky njësohet me një zyrtar në njërin nga funksionet e përcaktuara në kreun III, seksioni 2 të këtij ligji, gjyqtarët e prokurorët në nivelin e gjykatës së shkallës së parë e në atë të apelit, dhe asnjë shoqëri tregtare, ortakëri a shoqëri e thjeshtë, ku ky zyrtar zotëron, në mënyrë aktive apo pasive, aksione a pjesë në kapital, në gfarëdo sasive, nuk mund të lidhë kontratë ose nënkontratë me asnjë institucion publik”*

4.8 Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit të rivlerësimit me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova, pasi konstatoi se në lidhje me pronësinë këtyre aksioneve, subjekti i rivlerësimit është në shkelje të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar.

4.9 Në shpjegimet e tij subjekti deklaroi se bashkëshortja e tij ka qenë e punësuar në shoqërinë “***” që prej vitit 1988. Kur ky institucion u privatizua në vitin 2008 subjekti dhe bashkëshortja e tij përfituan aksione në vlerën 50.000 lekë secili. Subjekti sqaroi se në asnjë rast nuk kanë qenë në ndonjë marrëdhënie me këtë shoqëri me cilësinë e aksionerëve. Nuk kanë marrë pjesë në ndonjë procedurë prokurimi elektronik, si dhe nuk kanë ardhur asnjëherë në dijeni lidhur me procedurat e prokurimit ku shoqëria “***” ka marrë pjesë, është shpallur fituese dhe ka lidhur kontrata me institucione publike. Subjekti deklaroi se qenia aksioner në këtë shoqëri, rezulton të

²⁵ Ekstrakt i regjistrin tregtar për të dhënat e subjektit “***”, bashkëlidhur formular i kërkesave për blerje aksionesh për person fizik, shuma e paguar 50.000 lekë; ekstrakt i regjistrin tregtar për të dhënat e subjektit “***”, bashkëlidhur formular i kërkesave për blerje aksionesh për person fizik N.H., punonjëse e shoqërisë, shuma e paguar 50.000 lekë.

²⁶ Shkresa nr. *** prot., datë 26.12.2017 nga “***” sh.a.; shkresa nr. *** prot., datë 27.12.2017, e Agjencisë së Prokurimit Publik.

ketë qenë tërësisht formale dhe për sa më sipër, ishte vënë në dijeni nga hetimi administrativ i Komisionit. Në bazë të nenit 37, të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, subjekti ka filluar procedurat e zgjidhjes së këtij konflikti.

4.10 Duke vlerësuar pozitën në raport me interpretimin e ligjit, subjekti dhe bashkëshortja e tij kanë hequr dorë nga këto aksione, duke i dhuruar ato. Me kontratën e dhurimit pasuri të luajtshme nr. ***, datë 25.6.2019, ia kanë dhuruar këto aksione shtetases S.Sh., punonjëse e shoqërisë “****”. Në datën 26.6.2019, deklarata e dhurimit është depozituar në QKB dhe janë kryer procedurat e aplikimit për këtë dhurim.

Analiza ligjore e Komisionit

4.11 Ligjvënësi ka përcaktuar mënyrat bazë të trajtimit dhe të zgjidhjes së konfliktit të interesave nga zyrtarët, për parandalimin sa më të hershëm dhe sa më efikas të çdo konflikti interesi, të çdo lloji qoftë ai. Referuar nenit 37, të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, me ligjin nr. 44/2014, datë 24.4.2014, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005”, parashikohet se zyrtari, në ushtrimin e funksioneve të tij, paraprakisht, sipas rrethanës, nevojës, në mënyrë të shkallëzuar ose në proporcion me rëndësinë e situatës, mënjanon dhe zgjidh vetë çdo situatë të konfliktit të interesit, të çdo forme qoftë ajo, duke transferuar a tjetërsuar interesat privatë.

4.12 Mënjanimi apo parandalimi i konfliktit të interesit nga zyrtari lidhet me dijeninë e tij për situatën dhe rrethanën që e krijon atë, gjendur në këto kushte subjekti më anë të tjetërsimit të interesave privatë, duke dhuruar aksionet në emër të tij dhe bashkëshortes, bëri të mundur zgjidhjen e situatës së konfliktit të interesit në momentin që mori dijeni.

4.13 Komisioni vlerësoi gjithashtu faktin që subjekti dhe bashkëshortja e tij nuk rezultojnë të kenë lidhur kontrata apo nënkontrata me ndonjë institucion publik, vlera e këtyre aksioneve e zotëruar nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij është shumë e ulët, vetëm 0.000333333333%²⁷ secili, dhe për sa kohë që provohet burimi i ligjshëm i tyre, e përjashtojnë rrezikun e gjendjes në situatën e parashikuar në gjerat “b”, “c”, “ç”, të pikës 5, të nenit 33, si dhe në situatën e parashikuar në gjerat “d”, të ligjit nr. 84/2016, duke shmangur gjendjen në konflikt interesi me tjetërsimin/dhurimin e aksioneve. Pavaresisht nga fakti që shoqëria ka marrë pjesë në tender apo ka lidhur kontrata, subjekti nuk ka pasur rol vendimmarres duke qenë se vlera e aksioneve ka qenë e papërfillshme dhe për këtë arsye nuk provohet asnjëlloj konflikti.

5. Deklarim i personit tjetër të lidhur/vajzës së subjektit – B.H.

5.1 Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, personi tjetër i lidhur/vajza e subjektit deklaroi të ardhura nga paga e marrë nga puna provizore në Itali, në vitet 2014, 2015, 2016, në shumën 7.101,65 euro.

5.2 Në deklaratën e interesave private të vitit 2014 janë deklaruar të ardhura nga paga 1.600 euro, nga puna provizore në Itali (në Bari), të cilat i ka konsumuar po gjatë vitit 2014; (i) në dokumentin bashkëlidhur deklaratës “Vetting” të vitit 2017, (bustapaga) për vitin 2014, konstatohet se shuma e përfutur nga punësimi është 1.494 euro; (ii) në deklaratën e interesave private të vitit 2015 janë deklaruar të ardhura nga paga 4.121,65 euro, nga puna provizore në Itali (në Bari), të cilat i ka konsumuar po gjatë vitit 2015; (iii) në deklaratën e interesave private

²⁷ Referojuni ekstraktit të regjistrit tregtar për të dhënat e subjektit “****”, në dosjen e ILDKPKI-së.

të vitit 2016, janë deklaruar të ardhura nga paga 1.380 euro, nga puna provizore në Itali (në Trani), të cilat i ka shpenzuar po gjatë vitit 2015; (iv) janë deklaruar gjithashtu të ardhura nga bursa që i është dhënë nga Fakulteti ***, në Universitetin “***”, Bari Itali, gjatë viteve shkollore 2008/2009, 2009/2010 dhe 2012/2013, në vlerën 5.730 euro dhe të ardhurat e realizuara nga puna në bibliotekën e fakultetit në vlerë 930 euro.

5.3 Në lidhje me akomodimin e personi i lidhur/vajzës në Itali, sipas deklarimeve të subjektit, gjatë kohës që nuk ka fituar bursë është akomoduar në shtëpinë e motrës së subjektit, znj. S. M. (H.), e cila jeton në Bari të Italisë.²⁸

5.4 Në lidhje me shpenzimet për udhëtimet nga Itali - Shqipëri dhe anasjelltas, nga viti 2008 – 2016, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se shumicën e rasteve, janë përballuar nga vajza e tij me vlerat monetare që ka krijuara nga ndihma e prindërve, bursa dhe të ardhurat nga puna periodike, në disa raste edhe nga S.M.(H.).

5.5 Komisioni analizoi vlerat monetare që subjekti i rivlerësimit i ka dhënë vajzës së tij B.H., gjatë viteve 2008 – 2016, për të konkluduar nëse subjekti i rivlerësimit, personi i lidhur/bashkëshortja dhe personi tjetër i lidhur/vajza e subjektit, kanë pasur apo jo të ardhura nga burime të ligjshme për të bërë këto shpenzime. Subjekti deklaroi se të gjitha këto veprime janë pasqyruar në deklaratimet periodike të bëra nga ai dhe nga personat e lidhur.

5.6 Në analizën financiare janë marrë në konsideratë: (i) tarifë universiteti; (ii) shpenzime qëndrimi dhe fjetjeje viti 2013 (referuar vërtetimit të Universitetit për bursën e plotë të studimit), ndërsa për periudhën 2014 – 2016 vajza ka qëndruar në banesën e hallës së saj (motrës së subjektit të rivlerësimit)²⁹; (iii) bileta udhëtimesh (për udhëtimet me avion është konsideruar vlera prej 180 euro për biletë vajtje-ardhje dhe 100 euro vetëm një drejtim, vajtje ose ardhje - për udhëtimet me traget është konsideruar 40-45 euro vetëm një drejtim, vajtje ose ardhje).

5.7 Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit dhe ato të administruara gjatë hetimit, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaratim të saktë dhe në përputhje me ligjin, si dhe ka burime financiare me dokumentacion justifikues ligjor për të.

6. Konstatime të tjera nga hetimi administrativ

6.1 Depozita bankare në vitin 2005

6.1.1 Nga hetimi administrativ kryesisht i dokumentacionit të administruar nga “Raiffeisen Bank”³⁰, në lëvizjet e llogarive bankare janë konstatuar këto veprime: (i) depozitim nga subjekti i rivlerësimit në datën 30.6.2005, në vlerën 5.000 euro në llogarinë me nr. *** (e tërhequr më pas në datën 14.7.2005); (ii) depozitim nga subjekti i rivlerësimit në datën 30.6.2005, në vlerën 5.000 USD, në llogarinë me nr. *** (e tërhequr më pas në datën 14.7.2005)

6.1.2 Komisioni kreu analizën financiare për periudhën 1.1.2005 – 30.6.2005, duke qenë se depozitimet janë bërë gjatë kësaj kohe dhe konstatohet se ka mungesë dokumentacioni justifikues në këtë periudhë.

²⁸ Për të vërtetuar deklaratimet e tij, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur një kopje të kontratës së blerjes së shtëpisë së motrës në Bari të Italisë, në datën 9.5.2014, si dhe dokumentacion provues mbi të ardhurat e bashkëshortit në Itali.

²⁹ Për të vërtetuar deklaratimet e tij, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur: (1) certifikatë e historikut të vendbanimit të S.M. dhe I.M.; (2) certifikatë familjare e S.M.; (3) dokumentacion provues mbi të ardhurat e bashkëshortit të S.M., shtetasit I.M., në Itali për periudhën 2002 – 2018; (4) ekstrakt i aktivitetit tregtar të zhvilluar në Itali nga I. M., me fillim veprimtarie më 7.3.2007; (5) kopje të kontratës së blerjes së shtëpisë së S.M. dhe I.M. në Bari të Italisë në datën 9.5.2014; (6) deklaratë noteriale nr. ***, datë 21.6.2019, deklarues S.M.

³⁰ Shkresë nr. ***, datë 11.4.2018.

6.1.3 **Komisioni, bazuar në konstatimet e sipërpërmendura**, i kaloi barrën e provës subjektit të rivlerësimit, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

6.1.4 Subjekti shpjegoi se këto veprime janë kryer për efekt të pajisjes me vizë. Në ambasadën Italiane për t'u pajisur me vizë ka qenë kusht pasja e një depozite bankare. Duke qenë se në atë periudhë subjekti nuk kisha mjete monetare të mjaftueshme, znj. M.I., të cilën e kishte njohur në rrethana shoqërore, i ka dhënë hua vlerat monetare prej 5.000 euro dhe 5.000 USD, të cilat në datën 30.6.2005 janë depozituar në "Raiffeisen Bank". Subjekti është pajisur me vërtetim bankar dhe në datën 5.7.2005 ka aplikuar për vizë familjare në ambasadën italiane. Në datën 14.7.2005 të dy këto depozita bankare janë mbyllur dhe vlerat monetare prej 5.000 euro dhe 5.000 USD i janë kthyer znj. M.I.

Më tej, subjekti deklaroi se ky veprim nuk është deklaruar në deklaratën e interesave periodik për vitin 2005 për shkak të (i) marrjes dhe kthimit të huasë brenda një periudhe dy javore dhe (ii) në mbyllje të vitit subjekti nuk rezultonte me detyrime të pashlyera.

Subjekti, për të provuar pretendimet e tij, paraqiti deklaratën noteriale të znj. M.I., datë 22.6.2019, para noterit publik në New Jersey SHBA, e cila ka deklaruar se i ka dhënë hua subjektit vlerat monetare prej 5.000 euro dhe 5.000 USD, dhe pas mbylljes së depozitës ajo i ka marrë vlerat monetare të sipërpërmendura. Subjekti ka paraqitur *statement* nga "Raiffeisen Bank" për dy llogaritë bankare, si dhe fotokopje të pasaportës së tij dhe të familjarëve, ku evidentohet viza italiane në datën 11.7.2005.

6.1.5 Komisioni konstatoi se kjo hua përkon me periudhën e aplikimit për vizë në ambasadën italiane, si dhe kjo shumë është depozituar dhe tërhequr brenda një harku dy javor.

6.1.6 Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit dhe ato të administruara gjatë hetimit, krijoi bindjen se subjekti i rivlerësimit ka qenë i vërtetë në

6.2 Shuma prej 10.000 euro depozituar në vitin 2006 në llogari bankare

6.2.1 Nga hetimi administrativ, kryesisht për vitin 2006, në dokumentacionin e administruar nga "Raiffeisen Bank" është konstatuar se në datën 7.12.2006, subjekti i rivlerësimit ka depozituar 10,000 euro në llogarinë e tij me nr. ***, në "Raiffeisen Bank". Ky depozitim nuk është deklaruar në vitin 2006 por në vitin 2007.

6.2.2 Komisionit, bazuar në konstatimet e sipërpërmendura, i kaloi barrën e provës subjektit të rivlerësimit, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

6.2.3 Subjekti deklaroi se sipas analizës financiare të paraqitur prej tij, provon se ka pasur burime të mjaftueshme financiare për depozitimin në datën 7.12.2006 të vlerës monetare prej 10,000 euro. Kjo vlerë monetare ka pasur si burim kursimet nga paga e tij dhe bashkëshortes të grumbulluar në vitet 2004, 2005 dhe 2006, të cilat janë në vlerën e 1.800.000 lekëve, të deklaruara në deklaratat e interesave periodike për vitet 2004, 2005 dhe 2006.

6.2.4 Nga kjo vlerë në lekë subjekti kishte marrë 1.400.000 lekë, të cilat i ka konvertuar në euro në shumën 10.000 euro dhe në datën 7.12.2006 kjo shumë është depozituar në llogarinë bankare me nr. ***, në "Raiffeisen Bank". Shpjegimet e detajuara lidhur me burimin e krijimit të kësaj depozite subjekti i rivlerësimit i ka dhënë edhe në deklaratën e interesave private vjetore të vitit 2007.

6.2.5 Subjekti sqaroi se e ka deklaruar në deklaratën e interesave private periodike të vitit 2006, të plotësuar në datën 29.3.2007, në f. 8 "Të dhëna që nuk publikohen" në rekuizitën "Përshkruani hollësisht të dhënat e interesave private...": "Raiffeisen Bank (10.000), dega Krujë duke shënuar numrin e llogarisë.

6.2.6 **Komisioni**, pasi kreu analizën financiare bazuar në standardin e ILDKPKI-së, çmon se duken bindëse shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, si dhe doli në përfundimin se ka pasur të ardhura të ligjshme nga kursimet në vitet 2004, 2005 dhe 2006 për të krijuar këtë depozitë.

6.3 Gjetje të tjera të konstatuara gjatë hetimit administrativ

6.3.1 **Subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ ka deklaruar se** ka përdorur automjete të personave të afërm, miq të njohur për nevoja të ndryshme që ka pasur, veçanërisht për rastet kur ka dalë jashtë Shqipërisë, apo për të shkuar në fshatin e tij të lindjes Çernevale Kukës dhe në vendlindjen e bashkëshortes së tij në Gegë-Hysen, Tropojë.

7.3.2 Nga hetimi administrativ kryesisht u konstatua se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë përdorur makina të ndryshme për të udhëtuar jashtë Shqipërisë si: (i) me automjetin me targa ***, në pronësi të z. H.M., për të cilin subjekti deklaroi se ky shtetas është vëllai i bashkëshortes së tij, znj. N.H.; (ii) me automjetin me targa ***, në pronësi të z. E. L., për të cilin subjekti deklaroi se ky shtetas është djali i motrës së bashkëshortes së tij ; (iii) me automjetin me targa ***, në pronësi të znj. K.B., për të cilën subjekti deklaroi se shtetasja K.B., është vajza e mikut të familjes, z. K.B.

6.3.3 Komisioni, bazuar në faktet e dala nga hetimi, i kërkoi shpjegime subjektit në lidhje me: (i) dyshimet e Komisionit se automjeti me targa *** është *de facto* i subjekti të rivlerësimit, edhe pse *de jure* është në emër të z. H.M.

6.3.4 Pasi shqyrtoi shpjegimet e subjekti i rivlerësimit në lidhje me dyshimin e hedhur, Komisioni çmon se, subjekti arriti të shpjegojë bindshëm përtej dyshimeve, se ky automjet është në pronësi të shtetasit H.M., dhe pse duhet ta kishte deklaruar në Deklaratën Vetting 2017. Subjekti i rivlerësimit dha shpjegime shteruese lidhur me arsyet e përdorimit të këtij automjeti. Provohet se (i) pronar i ligjshëm i automjetit është z. H.M., (ii) provohet lidhja e tij, i cili është vëllai i bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit; (iii) taksat për këtë automjet janë paguar nga pronari i mjetit z. H.M., fakte të cilat, ezauruan çdo dyshim në lidhje me pronësinë e këtij automjeti.

7. Analiza financiare për periudhën 2003 – 31.12.2016

a. Metodologjia e përdorur për llogaritjen e shpenzimeve jetike

7.1 Për kryerjen e analizës financiare për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur, Komisioni, fillimisht gjatë hetimit dhe mbylljes së tij u bazua në të dhënat e INSTAT-it, sipas Anketës së Buxhetit të Familjes, duke qenë se janë shpenzime më të arsyeshme për një familje e cila ka një nivel të caktuar si kjo e subjektit të rivlerësimit.

7.2 Gjatë prapësimeve pas kalimit të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit, pretendoi se një përlllogaritje e tillë e shpenzimeve të jetesës, është e padrejtë, e paarsyeshme, dhe si rezultat në vlerë më të lartë se sa realisht këto shpenzime kanë qenë. Subjekti, gjithashtu, deklaroi se rrethana mbi të cilat është bazuar Komisioni në analizën e tij për mënyrën e jetesës nuk qëndrojnë për shkak se:

- i. Prej 18 vitesh që nga viti 2001 dhe aktualisht ai vazhdon të jetojë në një pallat të ndërtuar nga Enti i Banesave, pra, në një pallat social. Kushtet e banimit në një pallat social natyrisht që nuk janë të ndonjë cilësie të lartë jetese. Pallati – thotë subjekti - ka cilësi ndërtimi jo të lartë dhe në të mungojnë edhe elementët më minimal të banimit që sot i gjejmë pothuaj në çdo ndërtesë. Mungon dera e shkallës, mungon citofonia, shkallët janë me beton të varfër, mungojnë dritaret e shkallëve, etj.

- ii. Shpenzimet e shkollimit tetëvjeçar dhe të mesëm të të dy fëmijëve të tij kanë qenë minimale, në shkollën “***”, e cila gjendet përballë hyrjes së shkollës së pallatit ku subjekti banon, në distancë 100 m, ndërsa shkollimin e mesëm e kanë bërë në gjimnazet “****” dhe “***”.
- iii. Familja e tij ka pasur ndihmë të vazhdueshme nga prindërit e subjektit me produkte të prodhimeve bujqësore dhe blegtorale nga ekonomia e tyre personale. Subjekti shpjegon se prindërit kanë jetuar në fshat ku natyrisht kanë kultivuar kultura të ndryshme bujqësore dhe kanë mbajtur blegtori.

7.3 Komisioni, pasi analizoi shkaqet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit më lart, vlerëson se shpenzimet jetike duhet të llogariten sipas metodologjisë së përdorur nga ILDKPKI-ja në shkresën nr. ***, datë 4.3.2019. Më tej, Komisioni vlerëson se zbatimi i këtij standardi garanton trajtim të njëjtë për të gjithë subjektet e rivlerësimit, veçanërisht kur ky standard ka peshën kryesore në vlerësim.

7.4 Për sa i takon pretendimit të subjektit të rivlerësimit se përlllogaritja e shpenzimeve për jetesë nga Komisioni është bërë duke mos respektuar numrin e anëtarëve të familjes, ky pretendim nuk qëndron, pasi Komisioni e ka përlllogaritur numrin e anëtarëve të familjes, me tre anëtarë, në periudhën që vajza e subjektit ka qenë me studime jashtë vendit.

7.5 Komisioni, lidhur me shpenzimet e udhëtimit, vlerësoi që ato të mbeten të pandryshuara për shkak se në përlllogaritjet fillestare është marrë në konsideratë fakti që subjekti i rivlerësimit dhe familjarët e tij ka qëndruar tek të afërmit.³¹

b. Tabelë përmbledhëse e rezultateve financiare vjetore për periudhën e rivlerësimit

Viti	Të ardhurat	Pasuri	Shpenzime jetese ILDKPKI	Shpenzime për udhëtime nga sistemi TIMS	Shpenzime të tjera	Detyrimet	Diferenca për shpenzime
2003	1,233,517	8,621	375,456		56,910	- 131,137	661,394
2004	1,589,751	201,823	375,456	150,147	43,387	- 125,091	693,848
2005	1,684,965	845,782	438,228	433,353	34,112	- 147,533	- 214,043
2006	1,746,458	829,591	438,228	249,139	17,687	- 147,153	64,659
2007	1,791,800	811,311	696,288	371,621	3,367	- 83,541	- 174,328
2008	1,521,334	358,432	546,480	338,224	171,400	-	106,798
2009	1,734,738	74,812	409,860	292,995	382,921	-	574,150
2010	1,825,415	124,973	409,860	416,600	300,000	-	573,982
2011	1,820,288	- 82,914	409,860	577,604	665,300	-	250,438
2012	2,010,407	198,326	423,072	327,809	450,000	-	611,200
2013	2,042,326	421,405	423,072	201,924	569,900	46,600	472,625
2014	2,413,061	1,020,182	659,994	264,872	350,000	- 46,600	71,414
2015	3,353,551	7,852,539	672,828	233,744	906,935	6,314,133	1,637
2016	2,557,538	423,251	705,276	373,664	546,253	- 264,601	244,494
TOTAL	27,325,149	13,088,133	6,983,958	4,231,696	4,498,172	5,415,078	3,938,269

Komisioni vlerëson se balancat negative vetëm për dy vite 2005 dhe 2007, në shumën totale 388,371 lekë janë vlera të cilat nuk mund të përbëjnë shkak për shkarkimin e subjektit, nëse do marrim në konsideratë metodologjinë e përdorur për analizën financiare.

Konkluzioni për kriterin e vlerësimit të pasurisë

³¹ Për ditët e qëndrimit tek të afërmit u përlllogaritën 20 euro në ditë për persona të rritur; 10 euro në ditë për fëmijët në moshën 10-18 vjeç; 0 euro për fëmijët deri në 10 vjeç; biletat e avionit për linjat *low-cost* u konsideruan 180 euro, ndërsa për linjat e tjera 200 euro ose 220 euro, në varësi të linjës.

Në përfundim, trupi gjykues, bazuar në parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit, barazisë së palëve, si dhe duke respektuar të drejtat themelore të subjektit të rivlerësimit, në lidhje me vlerësimin e pasurisë, arrin në përfundimin se nga kontrolli i pasurisë ndaj subjektit të rivlerësimit, subjekti ka disa pasaktësi në deklarime dhe ka mungesë të ardhurash për dy vjet, të cilat nuk janë në atë shkallë sa të përbejnë shkaqe për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit.

Për rrjedhojë, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

VI. PROCESI I RIVLERËSIMIT TË KONTROLLIT TË FIGURËS

1. **Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (DSIK)** ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim DSIK-ja ka dërguar një raport me shkresën nr. *** prot., datë 26.10.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin e KDZH-së, nr. ***, datë 25.4.2018, për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39, të ligjit nr. 84/2016.

2. Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit, ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklarimit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.

3. **Si konkluzion**, Grupi i Punës konstaton përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, z. Zeqir Hoda.

4. Pavarësisht nga raporti i dërguar nga DSIK-ja, Komisioni ka kryer hetim administrativ nga ku rezulton se konstatimet e Grupit të Punës për kontrollin e figurës janë të sakta.

5. Më tej, Komisioni, konstaton se nuk ka asnjë informacion apo të dhënë që të implikojë subjektin në kryerjen e ndonjë veprë penale apo cenim të figurës, nuk ka denoncime apo të dhëna të tjera që të rezultojnë se subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016.

6. **Në përfundim, Komisioni çmon se**, subjekti i rivlerësimit e ka dorëzuar deklaratën për figurën në kohën e përcaktuar nga ligji nr. 84/2016, nuk ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar dhe nuk ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në lidhje me kontrollin e figurës, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës. Subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

VII. PROCESI I RIVLERËSIMIT PËR AFTËSITË PROFESIONALE

Subjekti rivlerësimit, në periudhën e rivlerësimit, ka kryer detyrat si më poshtë:

Në periudhën janar 2014 – 15.3.2016, drejtues i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kurbin, për periudhën 16.3.2016 – 15.7.2017, drejtues i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë, nga data 16.7.2017 e në vazhdim prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Prokuroria e Përgjithshme, si organi ndihmës për vlerësimin profesional që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në

Republikën e Shqipërisë “, ka përgatitur një raport për vlerësimin profesional referuar kritereve të mëposhtme të vlerësimit:

- a. aftësitë profesionale;
- b. aftësitë organizative;
- c. etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale;
- ç. aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

Pas analizimit të dokumentacionit të të dhënave të nxjerra nga formulari i vetëvlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga vetë subjekti, si dhe pesë dosjeve të vëzhguara të përzgjedhura me short dhe të dhënat nga burimet arkivore në Prokurorinë e Përgjithshme, Komisioni vlerëson se:

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Zeqir Hoda, tregon korrektësi në zbatim të ligjit. Në tre aktet procedurale ligjore të paraqitura prej tij dhe në pesë dosjet e vëzhguara sipas shortit është konstatuar se subjekti ka identifikuar normën ligjore të zbatueshme pothuajse në të gjitha rastet. Subjekti i rivlerësimit shfaq aftësi në arsyetim ligjor. Në përmbajtjen e akteve formohet lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve të arritura nga prokurori. Niveli i arsytimit të akteve të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor.

2. **Komisioni konstaton se** subjekti i rivlerësimit zotëron njohuritë ligjore dhe të arsytimit ligjor, në mbështetje të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

3. Nga aktet e përzgjedhura nga vetë subjekti, si dhe nga dosjet e hedhura në short, nuk rezultojnë të dhëna për përjashtimin e subjektit nga hetimi i çështjeve apo nga përfaqësimi në gjykim i tyre.

4. Subjekti i rivlerësimit tregon aftësi për të bashkëvepruar në mënyrë të përgjegjshme dhe korrekte me kolegët të nivelit më të ulët hierarkik, në menaxhimin e njëkohshëm dhe me efikasitet të masave dhe veprimeve procedurale hetimore me prioritet dhe të natyrës urgjente.

5. Subjekti i rivlerësimit rezulton se është aktivizuar me pjesëmarrje në trajnime brenda dhe jashtë vendit për aktualizimin dhe përsosjen e dijeve.

6. **Komisioni konstaton se** subjekti i rivlerësimit ka pasur gatishmëri për t’u angazhuar dhe i është nënshtruar programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, sipas pikave 4 dhe 5, të nenit 76, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Lidhur me etikën në punë, integritetin dhe paanësinë e magjistratit

7. Nga hetimi administrativ kryesisht u konstatua se subjekti i rivlerësimit kishte lëvizur një herë në hyrje dhe dalje në qershor të vitit 2012 me automjetin me targa ***, në pronësi të shtetasit Q.H. Ndaj këtij shtetasi rezultuan të ishin regjistruar në prokurori disa procedime për veprën penale të mashtrimit, sipas të dhënave në sistemin *TIMS*, për këtë arsye Komisioni pyeti subjektin e rivlerësimit në lidhje me rrethanat që e kishte njohur këtë shtetas.

8. Subjekti i rivlerësimit me anë të postës elektronike³² gjatë hetimit deklaroi se e ka njohur shtetasin Q.H., në Prokurori, pasi në vitin 2009 ka pasur në hetim një procedim penal, ku ky shtetas ishte person i kallëzuar. Gjithashtu, në vitin 2011 ka pasur në hetim një procedim penal, ku ky shtetas ishte i kallëzuar.

9. Në lidhje me automjetin në pronësi të z. H.M., subjekti i rivlerësimit në përgjigje të barrës së provës deklaroi se ky automjet ka qenë i z. H.M., i cili (siç edhe ka shpjeguar) është vëllai i

³² E-mail i datës 30.4.2019, ora 16:00.

bashkëshortes së tij N.H. Marrëdhëniet e subjektit, të bashkëshortes dhe në tërësi të familjes me kunatin H.M. dhe familjen e tij kanë qenë në vazhdimësi shumë të mira. Më tej, subjekti deklaroi se nga viti 2005 e më pas, në rastet e lëvizjeve me familjen jashtë shtetit apo edhe në lëvizjet për në fshatin e bashkëshortes në Geg-Hysen Tropojë (për shkak të kalimit nëpër Prizren-Gjakovë) ka pasur nevojën e përdorimit të një automjeti të përshtatshëm për këto lëvizje. Automjeti duhej të ishte tërësisht i rregullt në pikëpamje të dokumentacionit, si dhe të garantonte lëvizjen e gjatë. Subjekti, gjithashtu, deklaroi se përdorimi i këtij automjeti lidhet me nevojën që subjekti kishte për udhëtimin me një mjet të përshtatshëm për lëvizjet familjare jashtë shtetit. Subjekti deklaroi se pronar i ligjshëm i automjetit është z. H.M., dhe detyrimet në lidhje me këtë automjet janë paguar nga pronari i tij.

10. Komisioni, pasi shqyrtoi shpjegimet e subjekti i rivlerësimit në lidhje me dyshimin e hedhur, çmon se subjekti arriti të shpjegojë arsyet se përse ai kishte përdorur këtë automjet duke vënë theksin tek përshtatshmëria e makinës për të udhëtuar në zona malore të vështira, si dhe dokumentacioni provues që ky automjet ishte në pronësi të z. H.M. Subjekti i rivlerësimit dha shpjegime shteruese lidhur me arsyet e përdorimit të këtij automjeti. Provohet se: (i) pronar i ligjshëm i automjetit është z. H.M.; (ii) provohet lidhja e tij, i cili është vëllai i bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit; (iii) taksat për këtë automjet janë paguar nga pronari i mjetit z. H.M., fakte të cilat, ezauruar çdo dyshim në lidhje me pronësinë e këtij automjeti.

11. Lidhur me përdorimin e mjetit me targa ***, në pronësi të z. Q.H., subjekti deklaroi se këtë automjet e kishte përdorur për të shkuar, në fshatin Geg-Hysen, Tropojë. Udhëtimin e kishte kryer në mënyrë të menjëhershme me familjarët e tij, për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore të nënës së bashkëshortes, e cila jeton në këtë fshat. Rastësisht, subjekti kishte takuar shtetasin Q.H., i cili dispononte një automjet tip *fouristradë* “Toyota”, i përshtatshëm për t’u ngjitur në atë zonë me terren të vështirë malor. Këtij shtetasi i kishte kërkuar t’i jepte automjetin e tij për të shkuar në Tropojë, ku kishin qëndruar për 2 netë dhe më pas ia kishte kthyer menjëherë atë. Me shtetasin Q.H. është njohur në prokurori, pasi në vitin 2009 dhe në vitin 2011, ka pasur në hetim dy procedime penale, ku ky shtetas ishte person i kallëzuar. Subjekti deklaroi se në asnjë rast nuk rezultoi të jetë ndikuar drejtpërdrejtë ose tërthorazi nga përdormi i automjetit të shtetasit Q.H. Përdorimi i tij është bërë shumë kohë pasi është marrë vendimmarrja lidhur me procedimet penale, të cilat në çdo rast kanë qenë në përputhje me ligjin dhe se nuk e gjen veten në konflikt interesi.

12. Vlerësimi ligjor i Komisionit - Referuar nenit 6, kreu II, të ligjit 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, funksioni i magjistratit është i papajtuësëm me kryerjen e çdo veprimtarie që mund të ndikojë në pavarësinë e magjistratit, të krijojë ndonjë konflikt interesi ose, në çdo rast, të krijojë përshtypjen që magjistrati është i paanshëm dhe i pandikuar. Në nenit 6, të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, citohet se zyrtari ka për detyrë të parandalojë dhe të zgjidhë vetë, sa më parë dhe në mënyrën më të frytshme të mundshme, çdo gjendje të konfliktit të tij të interesit.

13. Komisioni çmon se në ushtrimin e detyrave dhe funksioneve zyrtare, prokurori nuk duhet të ndikohet nga interesa të ngushta personale. Në këtë kuptim, përmes veprimeve, mosveprimeve apo vendimmarrjes së tij, ai nuk mund të krijojë përfitime apo avantazhe për vete, për familjarët, të afërmit apo personat e tjerë fizike dhe juridikë. Në nenet 26 – 27 të Kodit të Procedurës Penale, janë përcaktuar shkaqet që përjashtojnë prokurorin nga ushtrimi i ndjekjes penale, duke shmangur çdo konflikt të mundshëm interesi, që ndikon ose mund të krijojë dyshime për paanshmërinë e tyre në ushtrimin e ndjekjes penale.

14. Subjekti paraqiti para trupit gjykues dy vendimet e pushimit që mbajnë datën 3.7.2009 dhe 5.10.2011, për procedimet penale nr. *** dhe nr. ***, ndaj shtetasit Q.H., ku është marrë “vendim për pushimin e procedimit penal”. Për sa më sipër, provohet fakti se subjekti e ka përdorur automjetin e këtij shtetasi, pas dhënies së vendimeve të pushimit për çështjet penale nën procedim, më konkretisht në qershor të vitit 2012.

15. Në përfundim, Komisioni vlerësoi se çështjet nr. *** dhe nr. ***, duhet të transferohen në bazë të pikës 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, pranë organit kompetent për inspektim për të verifikuar nëse evidentohen shkaqe që përbëjnë shkelje disiplinore, sipas ligjit për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ose nëse ka shkaqe për t’u marrë parasysh gjatë vlerësimit periodik të subjektit të rivlerësimit.

16. Në përfundim, Komisioni vlerësoi se transferimi i çështjeve të përmendura më lart, nuk është i mjaftueshëm për ta kualifikuar subjektin e rivlerësimit si “me mangësi” apo “i papërshtatshëm” në drejtim të vlerësimit të kriterit të aftësisë profesionale, në kuptim të pikave “b” dhe “c”, të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016, pasi subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve ose të viktimave, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme. Gjithashtu, çështja e përmendur nuk përbën shkak që mund ta çonte trupin gjykues në përfundimin se subjekti i vlerësimit ka cenuar besimin e publikut të dhënia e drejtësisë, në kuptim të pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

17. Konkluzionet për vlerësimin e aftësive profesionale

Vlerësimi i aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit u bazua në një analizë të bërë në përputhje me ligjin nr. 84/2016, “Për vlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në kreun II, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Trupi gjykues arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të gurmës “c”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016, por çështjet nr. *** dhe nr. ***, do të transferohet, në bazë të pikës 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, pranë organit kompetent për inspektimin e shkeljes disiplinore.

VIII. KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, Zeqir Hoda, ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- a. Ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.
- b. Ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.
- c. Ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas parashikimit të gurmës “c”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

Pavarësisht se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar kushtet në lidhje me tri kriteret e rivlerësimit për t’u konfirmuar në detyrë, Komisioni çmon se çështjet penale për të cilat është marrë vendimi “për pushimin e procedimit penal”, për procedimin penal nr. *** dhe nr. ***, për veprën penale “të mashtrimit” të parashikuara në nenin 143 të Kodit Penal, t’i transferohen organit kompetent për inspektim, sipas parashikimeve të pikës 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj.

Maria Tuma, dhe referuar gërmës “a”, të pikës 1, të nenit 58, si dhe pikave 1 dhe 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Zeqir Hoda, me detyrë prokuror pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Në zbatim të pikës 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, të përcjellë çështjen nr. *** dhe nr. ***, pranë organit kompetent për inspektimin e shkeljeve të mundshme disiplinore.
3. Vendimi i arsyetuar me shkrim u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, 30 ditë pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
4. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisionerit Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
5. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 8.7.2019.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Pamela QIRKO

Kryesuese

Genta TAFA (Bungo)

Anëtare

Etleda ÇIFTJA

Relatore

Sekretare gjyqësore
Olsida Goxhaj

